REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr. 326/19
Datum 09.09.2019
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH.nr. 326/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042,i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje: z.Blerim Dina– Kryetar, z.Nuhi Paçarizi –Referues, z.Goran Milenković–Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "Bajraktari" shpk, kundër njoftimit për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull te prokurimit:"Rregullimi i shtratit të Lumit Sitnica në Mitrovicë- Bashkëfinancim me MMPH" me numër prokurimi 642-19-3830-511 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Mitrovicës,më datën 24.07.2019 mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "Bajraktari" shpk, kundër aktivitetit me titull prokurimit "Rregullimi i shtratit të Lumit Sitnica në Mitrovicë- Bashkëfinancim me MMPH" me numër prokurimi 642-19-3830-511 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Mitrovicës.

II. OBLIGOHET, Autoriteti Kontraktues /Komuna e Mitrovicës /, ti bëjë ndryshimet e nevojshme në dosje e tenderit, në pajtim me nenin 53.7 të LPP-së,lidhur me aktivitetin e prokurimitme titull: "Rregullimi i shtratit të Lumit Sitnica në Mitrovicë- Bashkëfinancim me MMPH" me numër prokurimi 642-19-3830-511 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Mitrovicës.

IV. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

V.Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

VI. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankuesaprovohetpjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VII. Obligohen operatoret ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Data e njoftimit për kontratë: 03.06. 2019
Lloji i procedurës së aplikuar: Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar: Kontratë publike punë
Vlera e parashikuar e kontratës: 6,100,000.00 €
Kriteri për dhënie të kontratës (N.52): tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët

Me datën: 18.06.2019, OE "BAJRAKTARI" SHPK – Vushtrri, ka parashtruar ankesë në OSHP, kundër njoftimit për kontratë të aktivitetit të prokurimit: "Rregullimi i Shtratit të Lumit SITNICA në Mitrovicë – Bashkëfinancim me MMPH", me numër të prokurimit: 642-19-3830-511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Mitrovicë (KKM).

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 26.06.2019 ka autorizuar ekspertin shqyrtues tëprokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtuesdhe eksperti profesional në raportin e dt: 04.07.2019, konstaton dhe sqaron si në vijim:Përgjigje në Pretendimi nr. 1

Eksperti shqyrtues sqaron se në dosjen e re tek Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare në nenin 8.1 & 8.2 të FDT-së, është kërkuar si në vijim "Qarkullimi i përgjithshëm financiar në punët ndërtimore minimum 12,000,000.00 (për tri vitet e fundit deri në datën e publikimit të njoftimit për kontrate", ndërsa si Dëshmi e kërkuar dokumentare është kërkuar:

A) Deklaratë Tatimore Vjetore të Tatimit në të Ardhura ose Korporata të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës, duhet dorëzuar kopje.

Pas analizimit të dosjes së tenderit dhe pas analizimit të pretendimit ankimor të OE ankues "BAJRAKTARI" SHPK, eksperti shqyrtues konstaton se kërkesa "Qarkullimi i përgjithshëm financiar në

punët ndërtimore minimum 12,000,000.00 (për tri vitet e fundit deri në datën e publikimit të njoftimit për kontratë, duhet të ulët, sepse është kërkesë e lartë dhe e kufizon konkurrencën, si dhe duhet të hiqet kufizimi punët ndërtimore.

Përgjigje në Pretendimi nr. 2

Eksperti shqyrtues sqaron se në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë është kërkuar konkretisht tek Kapaciteti teknik dhe profesional, në nenin 9.1 & 9.2 të FDT-së, është kërkuar "Projekte të përfunduara të punëve në rregullim të shtretërve të Lumenjve në tri vitet e fundit deri në publikimin e njoftimit për kontratë. Vlera totale monetare e punëve te ekzekutuara jo më pak se 5,500,000.00 në lëmin e ndërtimit në rregullimin e shtretërve të Lumenjve", ndërsa si Dëshmi e kërkuar dokumentare është kërkuar: "Lista e projekteve të realizuara e nënshkruar dhe e vulosur, duhet të jetë në origjinal e përcjell me kontratën e noterizuar, procesverbalin e pranimit teknik ku (duhet treguar vlerën , vendin dhe kohen) si dhe referencën të kryerjes së punëve si në titull të këtij aktiviteti në rregullim shtretërve të Lumenjve, në tri vitet e fundit".

Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesa "Vlera totale monetare e punëve të ekzekutuara jo më pak se 5,500,000.00 në lëmin e ndërtimit në rregullimin e shtretërve të Lumenjve", është shumë e lartë vlera prej 5,500,000.00€, si dhe shumë kufizuese kërkesa në lëmin e ndërtimit në rregullimin e shtretërve të Lumenjve, si dhe në kundërshtim edhe me nenin 26.4 të Rregullave dhe Udhëzuesit operativ për prokurim publik, sepse aty shkruan qarte se "Gjate përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do ti kushtoj rëndësi të veçante zhvillimit të OE dhe do të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike".

Përgjigje në Pretendimi nr. 3

Në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë është kërkuar konkretisht tek Kapaciteti teknik dhe profesional, në nenin 9.1 & 9.2 të FDT-së, është kërkuar: "Menaxheri i Projektit Një (1) inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë, 10 vite përvojë pune pas diplomimit (drejtimi Hidroteknik)", tek Dëshmi e kërkuar dokumentare "Operatori Ekonomik, duhet të ofroj dëshmi 1a. Kontrata e punës e cila duhet të jetë primare me (liderin) dhe të jete ne listën e pagave të liderit në 6 muajt e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontrate".

Eksperti shqyrtues konstaton se këto kërkesa janë jashtë maksimumit të kërkuar, konkretisht kërkesaKontrata e punës e inxhinierit të jetë primare dhe të liste të pagave se paku në gjashtëmujorin e

fundit nga njoftimi për kontrate është kërkesë favorizues/diskriminuese dhe bie ne kundërshtim edhe me nenin 71 të LPP-së sepse në paragrafin 4 të këtij neni ceket qarte "Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtareve individual të grupit". Po ashtu neni 69.8 i LPP-së parasheh qarte "Një operator ekonomik mund, kur është e përshtatshme dhe për një kontrate të veçante, të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, pa marre parasysh natyrën ligjore të lidhjeve që ajo ka me ta".

Përgjigje në Pretendimi nr. 4

Në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë është kërkuar "Për te gjitha diplomat- kualifikimet e arritura (persona te diplomuar) në vendet jashtë Republikës së Kosovës kërkohet që diploma e tyre të jete e nostrifikuar dhe e vërtetuar në Republikën e Kosovës".

Eksperti shqyrtues mendon këto kërkesa janë të panevojshme, sepse këta inxhiniere nuk po aplikojnë për studime të doktoratës apo për ndonjë vend pune në institucione publike, edhe kjo kërkesë mendoj duhet të largohet sepse për çdo veprim apo mosveprim në pune mbajnë përgjegjësin pala nënshkruese e kontratës.

Përgjigje në Pretendimi nr. 5

Në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë është kërkuar "Referencat e punëve (hartim projektim dhe mbikëqyrje të lumenjve) në vlerë minimum 3.000.000 euro" .

Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesa hartim projektim dhe mbikëqyrje të lumenjve, është kërkesë kufizuese dhe diskriminuese.

Përgjigje në Pretendimi nr. 6

Në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë është kërkuar "Vërtetimi i lëshuar nga Policia e Kosovës qe dëshmon të kaluarën e pastër kriminale për pronarin e kompanisë, i cili duhet te lëshohet për pjesëmarrje në tender" si dhe "Vërtetim i lëshuar nga Policia e Kosovës për pjesëmarrje ne tender që dëshmon të kaluarën e pastër kriminale për menaxherin e projektit, jo me i vjetër se 3 muaj nga data e publikimit te njoftimit për kontrate".

Andaj eksperti shqyrtues konstaton se kjo kërkesë është kërkesë diskriminuese dhe duhet të hiqet nga dosja e tenderit sepse kjo kërkesë është jashtë çdo norme ligjore dhe jashtë çdo logjike si dhe cenohet edhe prezumimi i pafajësisë sepse nëse dikush mund të jetë nën hetime nuk nënkupton që është edhe fajtor.

Përgjigje në Pretendimi nr. 7

Në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë është kërkuar "OE (lideri) duhet te ofroje listën e punëtorëve nga ATK minimum 50 punëtor në 6 muajt e fundit nga data e publikimit te njoftimit për

kontrate".

Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesa OE (lideri) duhet të ofroje listën e punëtorëve nga ATK minimum 50 punëtor në 6 muajt e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontrate, është kërkesë diskriminuese dhe bie në kundërshtim edhe me nenin 71 të LPP-së sepse në paragrafin 4 te këtij neni ceket qarte "Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi" dhe jo ndaj/ anëtarëve individual të grupit", prandaj duhet të largohet kjo kërkesë dhe të ndryshohet.

Përgjigje në Pretendimi nr. 8

Në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë është kërkuar: "Lista e pajisjeve dhe dokumentet që ofrohen për makineri të obliguara sipas ANEXIT 1 të FDT-së, duhet të jenë të noterizuara dhe me regjistrim valid dhe ne rast konsorciumi lideri duhet ti ketë në pronësi 60% të pajisjeve".

Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesa "Lista e pajisjeve dhe dokumentet që ofrohen për makineri të obliguara sipas ANEXIT 1 të FDT-së, duhet të jenë të noterizuara dhe me regjistrim valid dhe ne rast konsorciumi lideri duhet ti ketë në pronësi 60% të pajisjeve", është kërkesë diskriminuese dhe bie në kundërshtim edhe me nenin 71 të LPP-së sepse në paragrafin 4 te këtij neni ceket qarte "Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi" dhe jo ndaj/ anëtarëve individual të grupit", prandaj duhet të largohet kjo kërkesë dhe të ndryshohet.

Përgjigje në Pretendimi nr. 9

Kërkesë e dosjen së tenderit konkretisht kërkesa e pestë (5) te nenit 9.1 & 9.2 të FDT-së, është "O.E. duhet të ketë minimum 4 punonjës të certifikuar si manipulues të eskavatorve nga një institucion i Republikës së Kosovës që posedon qendrën e trajnimit për këtë lëmi".

Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesa se kjo kërkesë është hapur diskriminuese sepse me ketë kërkesë nëse një punonjës i cili mund të jete i certifikuar jashtë shtetit të Kosovës nuk mund të jete i prezantuar nga kompania e caktuar në këtë aktivitet të prokurimit, e njëjta gjë qëndron edhe për kërkesat pikat 6, 7, 8 dhe 9.

Përgjigje në Pretendimi nr. 10

Në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë, konkretisht në pikën 10 të nenit 9.1 dhe 9. 2 të FDT-së është kërkuar "OE. duhet të ketë minimum 1 punonjës si manipulues për cisternat e karburanteve me ADR"

dhe dëshmi e kërkuar dokumentare është kërkuar "OE si dëshmi duhet të ofrojë Kontratën e punës, e

noterizuar Të jete në listën e pagave minimumi 6 muajt e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontrate, Certifikatën ADR, kopje e noterizuar".

Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesat "Certifikatën ADR" dhe kërkesa "Të jete në listën e pagave minimumi 6 muajt e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontrate", duhet të hiqen sepse janë sepse operatoret ekonomik mund të bëjnë edhe parakontrat apo kontrata para dorëzimit të ofertave për të përmbushur kërkesën e FDT-së, si Certifikata ADR, është diskriminuese/favorizuese, ku mund ta favorizoj apo diskriminoj ndonjë OE.

Eksperti shqyrtues konstaton se dosja e tenderit nuk është në harmoni me nenin 27 të LPP-së, dhe njëkohësisht AK-së gjatë përpilimit të dosjes së tenderit nuk e kane pasur përsysh as nenin 18.9 të RRUOPP ku shkruan qarte që "Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk: Kufizon konkurrencën në mesin e OE", ose "Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose me shumë EO-ve".

Eksperti shqyrtues konstaton se me kërkesat e dosjes së tenderit nuk janë marruar parasysh nenet 1, 6, 7, 68 dhe 69 të LPP-së.

Andaj duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesën e OE ankues ta aprovoj si të bazuar dhe ky aktivitet i prokurimit të kthehet në ri tenderim, duke i marruar parasysh të gjitha vërejtjet e cekura më lartë tek përgjigjet.

Operatori ekonomik"Bajraktari"përmes parashtresës me shkrim të datës: 05 korrik 2019, ka njoftuar panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 05 korrik 2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 24. 07. 2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues,përfaqësuesi i autoritetit kontraktues dhe operatorit ekonomik ankues, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë të OE-së së ankues deklaroj:"Ne qëndrojmë ne tërësi pranë pretendimeve ankimore te parashtruar ne ankesën e datës 18.06.2019 siç jeni te njoftuar edhe ju si panel shqyrtues dhe

OSHP ky AP i ritenderuar ka qenë edhe disa here me herët ne OSHP pra ka pasur ankesa mirëpo qe ne fund AP i nyejt i prokurimit është anuluar ne mungesë te ofertueseve te përgjegjshëm. Pas ritenderimit Autoriteti Kontraktues ka bërë je mori ndryshimesh ne kërkesat e FDT-së dhe njoftimit për kontrate duke i rritur kërkesat ne një mase jahte zakonisht te madhe edhe pse natyrisht është dashur qe ato kërkesa te zvogëlohen sepse AP i mëparshëm është anuluar ne mungesë te Ofertueseve te përgjegjshëm. Autoriteti Kontraktues ne FDT tek neni 8.1 dhe 8.2 ne lidhje me kërkesat mbi gjendjen tekniko financiare ka kërkuar qe qarkullimi i përgjithshëm financiar ne punëtndërtimore te jetë minimumi 12 MLN ne 3 vitet e fundit, ndërsa ne tenderin paraprak i cili ishte anuluar kjo vlere ka qen e parashikuar 8 MLN euro. Kjo ngritje e vlerës se kërkuar për mendimin tone është shume e paarsyeshme sepse nësenjë tender dështon ne një vlere te kërkuar prej 8 MLN euro atëherë si ka mundësi te realizohet apo te përfundon suksesshëm AP kur kjo vlere rritet ne 12 MLN euro. Gjithashtu qarkullimi i kërkuar për pune ndërtimore është kërkesë favorizuese sepse edhe me ligjin e LPP-së konkretisht me nenin 68 te LPP-së kërkesat ne fushat specifike nuk mund te kërkohen me shume se 1.5 here vlera e parashikuar e kontratës, ky kriter domosdoshmërish na jep te kuptojmë se i është përshtatur kompanive te caktuar dhe njëkohësisht diskriminon njënumër te madh te OE qe veprojnë ne Kosove, njëkohësisht është vepruar ne kundërshtim me nenin 7 te LPP-së. Kërkesëtjetër kufizuese dhe favorizuese është kërkesa e parashikuar ne nenin 9.1 dhe 9.2 te FDT-së ne lidhje me projektet e përfunduara ne rregullimin e shtretërve te lumenjve e ku ethe kërkuar minimumi 5.500.000 euro ndërsa ne tenderin paraprak ka qenë 3 MLN euro, prandaj ne nuk mund ti kuptojmë arsyet e këtyre ndryshimeve te bëra ne FDT gjithmonë duke pasur parasysh qe anulimi i AP paraprak te prokurimit është bërë për shkak te ofertuesve te pergjegjeshem. AK ka vepruar njëkohësisht ne kundërshtim me nenin 26.4 te RrUOPP-së sepse me këtë rast nuk ka pasur parasysh edhe OE te themeluar rishtazi e qe ne këtë dispozite parashihet qe duhet ti kenë parasysh. Poashtu kërkesëtjetër favorizuese është ne lidhje me udhëheqësin e punishtes dhe menaxherin e projektit ku është kërkuar përveç qe duhet ti kenë 10 përvoje pune dhe qe te kenë kontrata primare është kërkuar qe këta inxhinier te jene ne listat e pagave te liderit ne 6 muajt e fundit. Kjo kërkesë bie ne kundërshtim me nenin 71 par 4 te LPP-së sepse aty parashihet se kërkesat ne lidhjet me nenin 66,68 dhe 69 do te aplikohen ndaj Grupit si tërësi dhe jo anëtarit individual, poashtu edhe neni 69.8 i LPP-së e parasheh qartë se OE mund te mbështeten ne kapacitetet tjera te OE-ve te tjerë. Me këto kërkesa Autoriteti Kontraktues faktikisht e ka eliminuar ne një far forme konsorciumet dhe grupet e OE-ve dhe e fuqizon dhe favorizon vetëm liderin e grupit. Kërkesa te tjera qe janë favorizuese dhe diskriminuese janë edhe kërkesa qe kanë te beje me diploma dhe kualifikimet e stafit dhe inxhinierëve te cilët kanë diploma jashtëRepublikës se Kosovës e ku kërkohet qe te jene te nostrifikuara gjithashtu kërkesëtjetër e pa nevojshme dhe kundër ligjore është edhe kërkesa ne lidhje me menaxherin e projektit ku thuhet qe duhet te ofrohet vërtetim i lëshuar nga Policia Kosovës për

pjesëmarrje ne tender qe dëshmon te kaluarën e pastër kriminale. Neni 65 i LPP-së i parasheh rastet shume saktë dhe ne mënyrë recidive kur ndonjë OE nuk mund te merr pjese ne ndonjë AP nëse ndonjë drejtues oshe menaxher ethe i dënuar me vendim te formës se prere prandaj konsiderojmë se kjo kërkesë është jo ligjore por është edhe paarsyeshme dhe e pa nevojshme te figuron ne FDT sepse një inxhinier apo punëtor mund te jetë ne hetime por ekziston edhe prezumimi i pafajësisë i cili duhet te merret parasysh nga Autoriteti Kontraktues dhe çdo institucion dhe nuk nënkupton një ing apo punëtor qe është nen hetime qe nuk mund ti kryej punët dhe obligimet sipas kontratës. Kërkesëtjetër favorizuese është edhe se fakti qe është kërkuar qe Lideri te ofroj listën e punëtoreve nga ATK-ja min 50 punëtor ne 6 muajt e fundit, ndërsa dihet qe për projekte te ndryshme mund te lidhen edhe parakontrata me persona te caktuar profesional me qellim te realizimit te projektit. Edhe një kërkesë tjetër kufizuese është ku është kërkuar 4 punëtor te certifikuar si manipulues te ekskavatorëve nga ndonjë institucion i Republikës se Kosovës, me këte kërkesë nënkuptohet se punonjësit e certifikuar jahte Republikës se Kosovës i kufizojnë te jene pjesë e OE. Ne përgjithësi konsiderojmë se dosja e tenderit nuk ethe hartuar konform nenit 27 te LPP-së dhe me këto kërkesa nëse vazhdohet me tutje mund te mos arrihet qëllimi i LPP-së sepse mund te ofertojnë vetëm kompani te caktuara minimale dhe te cilat mund te ofertojnë me çmime jashtë zakonisht me te larta dhe me këtë rast te cenohet edhe neni 6 i LPP-së".

Në vazhdim fjala iu dha përfaqësuesit të AK-së z. Muzliukaj i cili deklaroj: Fillimisht do te theksoj qe mendimi i Eksperti Shqyrtues lidhur me këtë lende është kontradiktor sepse ne 90% te konstatimit te tije i përshkruan pretendimet e OE ankues. eksperti shqyrtues është i thirrur qe te jep mendime dhe konstatime lidhur me pretendimet e OE ankues. Thelbi i ankesës është ne 2 ceshtje ne aspektin financiar dhe tekniko profesionale.

Ne aspektin financiar AK KK-Mitrovice nuk e ka shkelur asnjë nen te ligjit te prokurimit publik te Kosovës ne Fuqi nuk do te lëshohemi ne nene dhe paragraf sepse ne përgjigje lidhur ne kërkesën për rishqyrtim janë te cekura ato.

Lidhur nga aspekti tekniko profesional duhet te kuptohet se ky tender ethe me vlere te madhe dhe ligjërisht kanë te drejtë te konkurrojnë kompani edhe nga jashtë Kosove dhe pika qe me se shumti ethe përdore tek pretendimet e OE ankues mirëpo për fat te keq edhe eksperti shqyrtues e kanë theksuar ceshtjen e nenit ku pretendohen qe duhet te ju lejohet edhe kompanive rishtas te themeluara për te marrur pjese ne këtë tender e qe i bie ne kundërshtim te plote me vlerën e kontratës se pretenduar.

Pika diskutabile lidhur me liderin e grupit duhet te theksohet qe prej ligjit te pare te LPP-së 2003/17 deri te hyrja ne fuqi e udhëzuesit te ri konsorciumet janë themeluar pa pasur mundësi te ndikohet nga autoriteti kontraktues lidhur me spec. teknike as nga aspekti financiar e as tekniko profesional. Kjo nënkupton qe

një kompani qe është themeluar sot ka mundur te fitoj tender 20 MLN dhe ka raste te shumta qe ato pune nuk kanë përfunduar asnjë here e rast konkret Auto Udha PRISHTINE – MITROVICE qe është filluar ne vitin 2009 nuk ka përfunduar ende, andaj tek neni 27 pika 4 e Udhëzuesit te prokurimit qartësohet qarte kompetencat e AK te përcaktoj kushtet për liderin dhe asnjë pretendim i OE ankues e as i eksperti shqyrtues. Nuk e theksojmë këtë prandaj me keqardhje duhet ta kuptojnë qe ky nen e përcakton qartë se kush duhet te jetë lideri i grupit te konsurciumit.

Për te gjitha çështjet tjera siç e ceka ne fillim dhe OE dhe eksperti shqyrtues duhet ta kenë te çart kur është tenderi ne vlera te më dha mundësi e kritereve duhet te jete me e madhe sepse ne këto projekte nuk guxojmë te dështojmë si AK për shkak te pa përgjegjësisë te OE i cili pretendon te jete fitues.

Gjatë prezantimit në seancë eksperti shqyrtues z. Muhadri deklaroj: Për shembull e marrim konstatimin nr 1. tek vlera ku është kërkuar 12 MLN ne 3 vitet e fundit kufizuese është rregullimi i shtratit te lumejve, inxhinieri me qenë ne listën e pagave ne 6 muajve te fundit te lideri i grupit. Mbetem prapa raportit te dhënë ne ekspertize.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues te aprovohet ankesa jone si e bazuar dhe te gjitha kërkesat qe janë te cekura ne ankese e qe janë favorizuese te ndryshohen me rastin e ritenderimit te këtij AP.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së deklaroj: Kërkojmë nga paneli qe te refuzoj ne tërësi ankesën e OE dhe te na lejohet neve si AK te vazhdojmë me te njëjtat kritere ne ritenderimin e kësaj lende duke dashur te kryhen këto projekte për qytetin tone.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit te palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor konstatoj se kërkesa e AK-së mbi gjendjen ekonomike dhe financiare në nenin 8.1 & 8.2 të FDT-së, - "Qarkullimi i përgjithshëm financiar në punët ndërtimore minimum 12,000,000.00 (për tri vitet e fundit deri në datën e publikimit të njoftimit për kontrate" nuk e kufizon konkurrencën, dhe nuk është kriter i lartë ne krahasim me aktivitetin e prokurimit.

Paneli shqyrtues konstaton se kërkesa e DT tek Kapaciteti teknik dhe profesional, në nenin 9.1 & 9.2 të

FDT-së, ku është kërkuar "Projekte të përfunduara të punëve në rregullim të shtretërve të Lumenjve në tri vitet e fundit deri në publikimin e njoftimit për kontratë. Vlera totale monetare e punëve te ekzekutuara jo më pak se 5,500,000.00 në lëmin e ndërtimit në rregullimin e shtretërve të Lumenjve", paneli shqyrtues konstaton se kërkesa është konform dispozitave të LPP-së duke pasur parasysh nenin 71 të LPP-së kjo kërkesë mund të plotësohet edhe nga OE që ofertojnë si konzurcium. Mund të plotësohet edhe vetëm por edhe në konzorcium në pajtim me nenin 71 të LPP-së sepse duke u bazuar në këtë nen të LPP-së kjo kërkesë nuk mund të konsiderohet si diskriminuese.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues se në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë është kërkuar konkretisht tek Kapaciteti teknik dhe profesional, në nenin 9.1 & 9.2 të FDT-së, është kërkuar: "Menaxheri i Projektit Një (1) inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë, 10 vite përvojë pune pas diplomimit (drejtimi Hidroteknik)", tek Dëshmi e kërkuar dokumentare "Operatori Ekonomik, duhet të ofroj dëshmi 1a. Kontrata e punës e cila duhet të jetë primare me (liderin) dhe të jete ne listën e pagave të liderit në 6 muajt e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontrate" paneli shqyrtues konstaton se këto kërkesa janë favorizuese/diskriminuese dhe bie ne kundërshtim edhe me nenin 71 të LPP-së sepse në paragrafin 4 të këtij neni ceket qarte "Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtareve individual të grupit".

Sa i përket pretendimit ankimor të OE ankues se kërkesa e e DT "Për te gjitha diplomat- kualifikimet e arritura (persona te diplomuar) në vendet jashtë Republikës së Kosovës kërkohet që diploma e tyre të jete e nostrifikuar dhe e vërtetuar në Republikën e Kosovës"është e panevojshme paneli shqyrtues konsideron se ky pretendim ankimor është i paqëndrueshëm për faktin se sipas Udhëzimit administrativ nr. 16/2016për parimet dhe procedurat e njohjes së diplomave, gradave dhe kualifikimeve të shkollave të larta profesionale dhe universitaret fituara jashtë RKS-së, njohja dhe barasvlera e kualifikimit të fituar jashtë vendit bëhet për të konfirmuar saktësinë dhe vërtetësinë e tij andaj në rastin konkret OE si punëdhënës duhet të vërtetoj se personat e diplomuar jashtë RKS të angazhuar si staf i kanë të vërtetuara diplomat e tyre.

Sa i përket pretendimit ankimor të OE ankues lidhur me kërkesën e DT: "Referencat e punëve (hartim projektim dhe mbikëqyrje të lumenjve) në vlerë minimum 3.000.000.000 euro" , paneli shqyrtues nuk e vlerëson kërkesën diskrimunese duke pasur parasysh natyrën e projektit dhe se OE i rekomanduar duhet të ketë përvojë në hartim projektim dhe mbikëqyrje të lumenjve.

Paneli shqyrtues konstaton se kërkesa e DT "Vërtetimi i lëshuar nga Policia e Kosovës qe dëshmon të kaluarën e pastër kriminale për pronarin e kompanisë, i cili duhet te lëshohet për pjesëmarrje në tender" si dhe "Vërtetim i lëshuar nga Policia e Kosovës për pjesëmarrje ne tender që dëshmon të kaluarën e pastër kriminale për menaxherin e projektit, jo me i vjetër se 3 muaj nga data e publikimit te njoftimit për kontrate", është diskriminuese dhe kufizuese dhe në kundërshtim me nenin 7 barazia në trajtim dhe diskriminimi dhe ne kundërshtim me nenin 65 dhe 66 te LPP-së.

Sa i përket pretendimit ankimor të OE ankues se në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë është kërkuar "OE (lideri) duhet te ofroje listën e punëtorëve nga ATK minimum 50 punëtor në 6 muajt e fundit nga data e publikimit te njoftimit për kontrate", paneli shqyrtues konstaton se kërkesa OE (lideri) duhet të ofroje listën e punëtorëve nga ATK minimum 50 punëtor në 6 muajt e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontrate, është kërkesë diskriminuese dhe bie në kundërshtim edhe me nenin 71 të LPP-së sepse në paragrafin 4 te këtij neni ceket qarte "Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi" dhe jo ndaj/ anëtarëve individual të grupit", prandaj duhet të largohet kjo kërkesë dhe të ndryshohet.

Sa i përket kërkesës së dosjes së tenderit: "Lista e pajisjeve dhe dokumentet që ofrohen për makineri të obliguara sipas ANEXIT 1 të FDT-së, duhet të jenë të noterizuara dhe me regjistrim valid dhe ne rast konsorciumi lideri duhet ti ketë në pronësi 60% të pajisjeve", paneli shqyrtues konstaton se kërkesa "Lista e pajisjeve dhe dokumentet që ofrohen për makineri të obliguara sipas ANEXIT 1 të FDT-së, duhet të jenë të noterizuara dhe me regjistrim valid dhe ne rast konsorciumi lideri duhet ti ketë në pronësi 60% të pajisjeve", është kërkesë diskriminuese dhe bie në kundërshtim edhe me nenin 71 të LPP-së sepse në paragrafin 4 te këtij neni ceket qarte "Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi" dhe jo ndaj/ anëtarëve individual të grupit", prandaj duhet të largohet kjo kërkesë ose të ndryshohet.

Sa i përket kërkesës së dosjes së tenderit konkretisht kërkesa e pestë (5) e nenit 9.1 & 9.2 të FDT-së, është "OE duhet të ketë minimum 4 punonjës të certifikuar si manipulues të eskavatorve nga një institucion i Republikës së Kosovës që posedon qendrën e trajnimit për këtë lëmi", paneli shqyrtues konstaton se kjo kërkesë është diskriminuese sepse me ketë kërkesë nëse një punonjës i cili mund të jete i certifikuar jashtë shtetit të Kosovës nuk mund të jete i prezantuar nga ndonjë Operator ekonomik në këtë aktivitet të prokurimit, e njëjta gjë qëndron edhe për kërkesat pikat 6, 7, 8 dhe 9, por AK mund te kërkoj ekuivalente

ose te nostrifikuar (nëse aplikohet edhe për certifikata konform ligjeve ne fuqi).

Në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë, konkretisht në pikën 10 të nenit 9.1 dhe 9. 2 të FDT-së është kërkuar "OE duhet të ketë minimum 1 punonjës si manipulues për cisternat e karburanteve me ADR"dhe dëshmi e kërkuar dokumentare është kërkuar "OE si dëshmi duhet të ofrojë Kontratën e punës, e noterizuar të jete në listën e pagave minimumi 6 muajt e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontrate, Certifikatën ADR, kopje e noterizuar", të cilët OE ankues e konsideron si favorizuese dhe diskriminuese, paneli shqyrtues konstaton se në bazë të dispozitave të LPP-së kjo kërkesë nuk mund të konsiderohet favorizuese për faktin se në asnjë dispozitë nuk është e specifikuar se kërkesa të tilla ose të ngjashme favorizojnë një OE ekonomik dhe diskriminojnë ndonjë tjetër.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 OE- "Bajraktari"
1x1 AK- KK Mitrovice
1x1 Arkivës së OSHP-së;
1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.